



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “KS Scardian JSC” Sh.A. të datës 25.08.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 21.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi dhe kontrollimi teknik i automjeteve të Komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit 616-23-5923-2-1-1 dhe me numër të brendshëm 616-23-118-211, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “KS Scardian JSC” Sh.A. të datës 25.08.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 21.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi dhe kontrollimi teknik i automjeteve të Komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit 616-23-5923-2-1-1 dhe me numër të brendshëm 616-23-118-211.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “KS Scardian JSC” Sh.A. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “KS Scardian JSC” Sh.A. (tutje “parashtruesi”) me datë 25.08.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 21.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi dhe kontrollimi teknik i automjeteve të Komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit 616-23-5923-2-1-1 dhe me numër të brendshëm 616-23-118-211.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: “Gjeni të bashkangjitur linkun nga BQK (<https://bqk-kos.org/?id=21>) në të cilin mund të bazoheni për tarifatat fikse të përcaktuara për kompanitë e sigurimit. Ky tender duhet të rievluohet edhe njëherë dhe të merren parasysh që në pikat 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 18, 19, 21, 23, 26, 27, 28, 29, 34 & 35. Specifikat janë dhënë me peshën bartëse p.sh. pika 10 ka peshë max. të lejuar 7490 e cila sipas tarifave fikse (të BQK) çmimi është 535.72 EUR kontrolleri teknike në vlerë 50 EUR = çmimi i përgjithshëm 585.72 EUR. Sipas OE Eurosig çmimi është dhënë total 248.24 EUR çmimi i cili nuk është sipas specifikave të dosjes”.

Lidhur me pretendimet e parashtruesit:

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet parashtruesit janë të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 30.08.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.